

Dhoma e Audituesve të Autorizuar



Комора
овлашћених
ревизора

Boško Vidaković

25. tetor, Vjenë

Komuniteti i Praktikës së Raportimit Financiar

CFRR >>

**Centre for Financial
Reporting Reform**




WORLD BANK GROUP
Governance



Road to Europe: Program of Accounting
Reform and Institutional Strengthening



EU-REPARIS is funded by the
European Union and is a part of
WB EDIF.



Rezultatet e programit të kontrollit të cilësisë

- » **Ligji për Auditimin** është miratuar më 16 korrik 2013 nga Asambleja Kombëtare e Republikës së Serbisë dhe është botuar në Gazetën Zyrtare nr.62/13. Ligji ka hyrë në fuqi më 24 korrik 2013.
- » Ligji për Auditimin ka krijuar kuadrin ligjor për zbatimin e programit të kontrollit të cilësisë.

» **Zbatimi i sistemit për mbikëqyrjen publike** – u fut në zbatim Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike – një organ i pavarur anëtarët e të cilit nuk janë ushtrues të profesionit (individë të janë të pavarur nga profesioni i auditimit dhe Dhoma e Audituesve të Autorizuar), emërohen nga Qeveria e Republikës së Serbisë, me propozim të Ministrisë së Financave, Bankës Qendrore dhe Komitetit të Letrave me Vlerë, dhe ka këto role:

- Mbikëqyr sistemin e kontrollit të cilësisë dhe vendos masa ndaj shoqërive të auditimit dhe audituesve të licencuar të autorizuar;
- Mbikëqyr arsimin e vazhdueshëm dhe procesin e provimit;
- Mbikëqyr Dhomën e Audituesve të Autorizuar;
- Mbikëqyr procesin e dhënies së licencave për audituesit e autorizuar dhe jep lejet e punës për shoqëritë e auditimit;
- Sugjeron sanksione disiplinore për shoqëritë e auditimit dhe audituesit e licencuar.

» **Sistemi i kontrollit të cilësisë është i ngritur**

» » Kontrolli i cilësisë zbatohet nga punonjës të pavarur të kontrollit të cilësisë, të cilët janë auditues të licencuar të autorizuar të punësuar në Dhomën e Audituesve të Autorizuar, me të paktën pesë vjet përvojë në auditim.

» » Të gjitha shoqëritë e auditimit dhe audituesit e licencuar janë objekt i KC-së. Bëhet të paktën një herë çdo tre vjet për shoqëritë e auditimit që kryejnë auditim të njësive ekonomike me interes publik dhe të paktën një herë në gjashtë vjet për gjithë të tjerët.

» » Procesi i kontrollit të cilësisë është bërë funksional në 2015.

- » Përgatitjet për programin e kontrollit të cilësisë filluan në vitin 2012, në parapritje të ligjit të ri për auditimin.
- » Metodika për kontrollin e cilësisë është hartuar me ndihmën e dhomës hungareze të auditimit, CFRR-së dhe NBA-së.
- » Përvojat e tyre janë zbatuar në sistemin tonë të kontrollit të cilësisë.

» Është kryer kontrolli i cilësisë në:

49 shoqëri auditimi

98 auditues të licencuar të autorizuar që kanë

125 angazhime auditimi.

» Ministria e Financave, me propozim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, ka vendosur:

11 sanksione për shoqëri auditimi që janë:

10 urdhra për eliminim të parregullsive;

1 leje pune e revokuar;

» Ministria e Financave, me propozim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, ka vendosur:

21 sanksione ndaj audituesve të licencuar të autorizuar:

9 paralajmërime publike;

10 heqje me kusht të licencës;

2 heqje licence;

- » Është miratuar programi i ZHPV-së për t'u dhënë zgjidhje problemeve të identifikuara gjatë kontrollit të cilësisë.
- » Konstatimet e kontrollit të cilësisë vihen publikisht në dispozicion dhe janë temat kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të profesionit.

- » Nga viti në vit po e përmirësojnë cilësinë e punës së kryer nga audituesit e licencuar dhe shoqëritë e auditimit.
- » Gjatë tre viteve të fundit kemi vënë re një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së përgjithshme të auditimeve të kryera në Republikën e Serbisë.

Faleminderit